



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Fjala e Prof. Doktor Muhamet Mehmeti mbajtur në emër të kosovarëve tek varri i Enver Hoxhës

I nderuari shoku Enver!

Kemi ardhur nga Kosova për t'iu bashkuar bashkëkombasëve dhe miqve të nderuar nga bota e jashtme që me rastin 100 vjetorit të ditëlindjes Tënde, 16 Tetorit, nga distanca e tanishme kohore, të shprehim ndjenjat dhe dhimbjen që mbetëm pa prezencës fizike Tënde, por pa lënë anash dhe ndjenjën e krenarisë për veprën madhështore, epokale që Ti krijove në dobi të kombit shqiptar, për çka Ti je përhërë i gjallë në zemrat tona.

Ti gjithmonë ke mendua dhe vepruar për të mirën e popullit, për forcimin e shtetit shqiptar dhe në asnjë rast nuk e harrove Kosovën – vendin e përkushtuar ndaj dëshirave dhe angazhimeve për të bashkëjetuar me shtetin amë, Shqipërinë.

Të motivuar në një shkallë të lartë të humanitetit Ti gjithmonë shprehe gatshmërinë që të sakrifkohesh në realizimin e qëllimeve Tua të larta, lirinë, mirëqeniën dhe bashkimin e popullit shqiptar në një shtet.

Krahas këtij veprimi fisnik Ti kurrë nuk pate fobi për të nxitur urrejtje ndaj popujve të tjerë, por gjithnjë shprehe respektin duke preferuar dhe duke u angazhuar për barazinë njerëzore.

Çdo patriot shqiptar i është mirënjohës veprës Tënde, e cila ngriti vullshëm gjallërinë e kombit përmes arsimit, ekonomisë, shtetit të organizuar e të orientuar në dobi të interesave të kombit.

Ti, i nderuar Enver, me aftësitë e Tua, me inteligjencën Tënde, me motivet dhe me mënyrën e sjelljes dhe të vepruarit me zgjuarsi krijove epokë të madhe historike, epokë kjo e cila bëri hapa të mëdhenj e të rëndësishëm të zhvillimit.

Për tërë këtë që bëre, i nderuar Enver, të jemi mirënjohës të gjithë, e posaçërisht kosovarët të janë mirënjohës për përkrahjen dhe angazhimin e vazhdueshëm që bëre për çlirimin e Kosovës. Në zemrat e patriotëve shqiptarë, në zemrat e intelektualëve të vërtetë dhe të masës popullore të vetëdijshme për veprën Tënde madhështore që krijove për shumë vite me radhë, Ti, Enveri ynë i dashur, do të mbetesh gjithmonë i gjallë!